

Ditari Naturës

Në këtë numër do të gjeni:

- **Ekomuzeumi Vjosa/Aoos, workshop trajnues për ngritjen e kapaciteteve.**
- **Seminar Rajonal për bashkëpunimin ndërkufitar: nga Vizioni në Veprim.**
- **Përgatitja e dokumentacionit për shpalljen e Parkut Detar të Porto Palermos.**
- **Dita e Verës, Parku Kombëtar Prespë.**
- **Vazhdon procesi i shpalljes së Parqeve Natyrore Rajonale.**
- **Aksion ndërgjegjësues në mbrojtje të pasurive natyrore dhe turistike të Sarandës.**
- **Përditësime nga çështja “Antea”**

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri i uron një vit të mbare të gjithë lexuesve dhe nëpërmjet tyre të gjithë miqve, kolegëve dhe bashkëpunëtorëve tanë, duke i falenderuar për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin e frytshëm në fushën e ruajtjes së natyrës dhe mjedisit në vendin tonë. Në kemi bindjen që Viti i Ri 2014 do të jetë me më shumë bashkëpunime, angazhime e përpjekje në realizimin e qëllimit tonë të përbashkët, ruajtjen e natyrës shqiptare dhe krijimi i një mjedisi sa më të qëndrueshëm për sot dhe brezat që do të vijnë.

Ekomuzeumi Vjosa/Aoos, workshop trajnues për ngritjen e kapaciteteve

Në datë 5 - 6 Dhjetor 2013 në ambientet e Qendrës Multifunkionale në qytetin e Përmetit, Institutin për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) në bashkëpunim me Bashkinë Përmet, në kuadër të projektit VAEcoM “Ekomuzeumi i lumit Vjosa/Aoos; promovimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore e basenit të lumit Vjosa/Aoos”, si pjesë e programit IPA ndërkufitar “Greqi – Shqipëri 2007-2013” financuar nga fondet Evropiane si dhe fondet kombëtare të Shqipërisë dhe Greqisë, organizoi Seminarin Trajnues për Ngritjen e Kapaciteteve.

Qëllimi i këtij seminary ishte të sigurojë guidën e nevojshme për operatorët (popullsinë lokale) që do të jenë pjesë e Ekomuzeumit të lumit Vjosa/Aoos, për të kuptuar si të bashkëpunojnë mes tyre për të menaxhuar ekomuzeumin si dhe për të kuptuar mundësitë që ky ekomuzeum mund të sjellë në të ardhmen për zhvillimin e zonës. Ai do të fokusohet mbi informacionin e nevojshëm dhe modelimin e bashkëpunimit gjithë përfshirës me aktorët, operatorët, dhe OJF-të lokale *Vijon në faqe 2*



Vijon nga faqe 1

në zonën e luginës së Vjosës. Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit u pajisën edhe me një certifikatë.

Ekumuzeumi i basenit të lumit Vjosa/Aoos është një projekt i cili ka nisur nga zbatimi si iniciative e përbashkët e dy organizatave jo qeveritare, Instituti Mesdhetar për Natyrën dhe Anthropos (MED-INA) në Greqi dhe Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA). Puna për ngritjen e këtij eko-muzeumi ka edhe ndihmesën e partnereve lokal në të dy anët e kufirit Grek-Shqiptar, Pindos Perivallontiki në Greqi dhe Drejtorja e Shërbimit Pyjor Përmet dhe Bashkia Përmet në Shqipëri. **Synimi i projektit** është të ngrejë dhe të zhvillojë një ekumuzeum ndërkufitar i cili do të shtrihet në rajonin ndërkufitar të Greqisë dhe Shqipërisë, me fokus trashëgiminë natyrore e kulturore të basenit të Lumit Vjosa/Aoos, duke përfshirë të gjitha aspektet produktive, mjedisore dhe social kulturore. Një muze i tillë “i gjallë”, pa mure, shumë dimensional duke inkorporuar në të jo vetëm shkencën dhe edukimin por edhe dimensionet psikologjike sociale dhe shpirtërore të komunitetit përreth.

Ngritja e një ekumuzeumi për basenin e lumit Vjosa/Aoos përmes kërkimeve dhe bashkëpunimit me komunitetin lokal ka krijuar edhe një rrjet pune me operatorët lokal i cili do të çojë më tej aktivitetin e projektit duke bërë të njohur ekumuzeumin dhe duke zgjeruar mundësitë për

bashkëpunim ndërkufitar përtej jetës së projektit. Rrjeti i punës së Ekumuzeumit Vjosa/Aoos në Shqipëri do të menaxhohet nga anëtarët e rrjetit dhe do të jetë pjesë e rrjetit të përbashkët (Al-Gr) bazuar mbi një memorandum të përbashkët të firmosur nga të gjithë anëtarët e rrjetit në të dy vendet.

Ekumuzeumi i lumit Vjosa/Aoos pritet të hapi dyert në Shkurt të vitit 2014 në Qendrën Multifunktionale pranë Bashkisë Përmet.

Eventualisht, ky projekt do të ketë një impakt të dukshëm pozitiv mbi një zonë të rëndësishme ndërkufitare me implikime të konsiderueshme socio-kulturore, ekonomike dhe mjedisore. Pritet që bashkëpunimi ndërkufitar midis rajoneve të Greqisë dhe Shqipërisë do të përmirësojë komunikimin midis menaxherëve aktual të zonave të mbrojtura respektive dhe do të ndihmojë në nxitjen e bashkëpunimit të ardhshëm për menaxhimin e burimeve natyrore.

Ekumuzeumi i basenit të lumit Vjosa do të vazhdojë të jetë një institucion permanent, me bazë zonën dhe me të paktën dy pika fillimi nga një në çdo vend, duke vepruar në shërbim të shoqërisë lokale dhe vizitoreve. Ai do të ndihmojë komunitetin lokal në të dy anët e kufirit që përmes pjesëmarrjes aktive të promovojnë dhe të mbrojnë mjedisin e tyre natyror, të ruajnë traditat e paraardhësve të tyre dhe njëkohësisht të zhvillojnë ekonomitë e tyre.

Seminar Rajonal për Bashkëpunimin Ndërkufitar: nga Vizioni në Veprim

Proceset e krijimit të Rezervave Ndërkufitare të Biosferës (TBR) në rajon duhet të mbështeten pasi ato ndodhen në një moment kritik ku palët e interesuara kërkojnë mbështetje dhe autoritetet, së bashku me komunitetet, kanë nevojë për sqarim mbi angazhimin e tyre, përgjegjësitë si dhe përfitimet që priten me qëllim që të vijohet

me proceset e përcaktimit dhe zbatimit të funksioneve kryesore dhe të ndërlidhura të (T)BRS-ve të tilla si: ruajtja e mjedisit, kërkimi shkencor mbi ndërveprimet njeri-mjedis, zhvillimi i qëndrueshëm (SD), identiteti kulturor dhe të mësuarit për një të ardhme të qëndrueshme në kontekstet rajonale dhe globale.

Seminari Rajonal dy ditor “Nga Vizioni në Veprim” mbi Bashkëpunimin Ndërkufitar, lidhur me Bashkëveprimin ndërmjet Njeriut dhe Natyrës, synoi forcimin e kapaciteteve të aktorëve që janë pjesë e Komiteteve Kombëtare të Programit MAB (Programi Njeriu dhe Biosfera) dhe atyre që do të sigurojnë menaxhimin e vazhdueshëm të TBR-ve të ardhshme, si dhe të nxisë proceset pjesëmarrëse për të zbatuar funksionet kryesore në terren duke konsideruar gjithashtu një kontribut të mundshëm në zbatimin e strategjisë së ardhshme të pro-



Vijon në faqe 3

Vijon nga faqe 2 gramit MAB dhe Rrjetit të tij Botëror të Rezervave të Biosferës (WNBR).

Objektivat e seminarit kanë të bëjnë me thirrjen e një takimi me aktorët dhe ekspertët kryesorë të përmendur më lart me qëllim që të mundësohet:

- ndarja e informacionit, përvojës, mësimëve të nxjerra dhe praktikave më të mira në menaxhimin e rezervave të biosferës dhe proceseve ndërkufitare për të adresuar sfidat e reja me të cilat po ndeshemi
- forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar duke theksuar në mënyrë të veçantë territoret kufitare ku ujërat ndërkufitare dhe ekosistemet e lidhura me to mund të preken nga një zhvillim i pa qëndrueshëm për shkak të qasjeve të ndryshme menaxheriale;
- arritja e një kuptimi të përbashkët të konteksteve institucionale, ligjore dhe rregullatore në zbatimin e funksioneve kryesore të TBR dhe nxitja e hartimit të një strategjie të përbashkët dhe planit të veprimit të lidhur me të.

Përfaqësuesit e lartë të Shqipërisë (Znj. Diana Bejko, Zëvendës Ministre e Mjedisit) dhe Maqedonisë (Z. Stevo Temelkovski, Ministria e Mjedisit, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) mbështetën qartësisht procesin duke treguar angazhimin tyre ndaj nismës për krijimin e TBR-së së Basenit Ujëmbledhës së Liqeneve Ohër-Prespë dhe administrimin e rregullt të tij pasi të jetë përcaktuar zyrtarisht.

Dita e parë e seminarit ju përkushtua diskutimit ndërmjet

përfaqësuesve të Komiteteve Kombëtare të MAB nga Shqipëria, Bullgaria, Ish republika Jugosllave e Maqedonisë, rreth statusit të procesit periodik të rishikimit për BR ekzistuese; propozimet për krijimin e (T)BR-ve të reja; funksionimit të Komiteteve Kombëtare të MAB; çështjeve përkatëse për politikën kombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm (SD). Dita e dytë e seminarit u hap për palët e interesuara kombëtare dhe lokale me një fokus të veçantë mbi TBR-të e propozuara të Basenit Ujëmbledhës të Liqeneve Ohër-Prespë, Liqenit të Shkodrës dhe Maleve Osogovo.

Rishikimii proceseve të TBR-ve nga Baseni Ujëmbledhës i Liqeneve Ohër-Prespë, Malet Osogovo dhe Liqeni i Shkodrës, ofruan shembuj të dobishëm për qasjet e ndryshme ndaj krijimit të TBR-ve. Mësimet e nxjerra dhe idetë rreth rrugës që shtrihet përpara, ishin thelbi i diskutimeve ndërmjet pjesëmarrëse. Pjesëmarrësit pranuan që duhet të bëhen më shumë përpjekje për të kuptuar dhe promovuar konceptin e TBR-ve si një mjet që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm duke respektuar natyrën. Ekziston një nevojë për më shumë aktivitete të ngritjes së kapaciteteve si dhe përdorimin e materialeve ekzistuese të ndërgjegjësimit të publikut mbi konceptin e MAB dhe BR.

Z. Philippe Pypaert, përgjegjës për Programet e Mjedisit të Zyrës Rajonale të UNESCO-s për Shkencën dhe Kulturën në Evropë (Venecia, Itali), ofroi mbështetje të plotë të procesit të krijimit të TBR-venë rajon.

Përgatitja e dokumentacionit për shpalljen e Parkut Detar të Porto Palermos

Në datë 9 Dhjetor 2013, në ambientet e Këshillit Bashkiak Himare, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri në bashkëpunim me shoqatën mjedisore “Adriatiku”-Vlorë dhe me Bashkinë Himare, organizuan takimin me temë “Përgatitja e dokumentacionit për shpalljen e Parkut Detar të Porto Palermos”.

Ky takim u zhvillua në kuadër të programit "Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në fushën e Mjedisit në Shqipëri (SENIOR-A)" me asistencë të Qendrës Rajonale të Mjedisit – REC Albania dhe financuar nga Qeveria Suedeze.

Takimi pati si qëllim njohjen e komunitetit vendas me projektin “Mbrotjtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i zonave të mbrojtura”, ecurinë si dhe progresin e deritan-



ishëm të këtij procesi gjithë përfshirës, shkëmbimin e ideve dhe dëgjesa e komunitetit lidhur me këtë zone, vlerat dhe rëndësinë e saj.

Dita e Verës, Parku Kombëtar Prespë

20 Dhjetori shënoi Ditën e Verës për prodhuesit e verës në zonën e Prespës. Për të festuar këtë ditë, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe organizata lokale Green & Clean Korçë, në bashkëpunim



me Komunën Pustec dhe administratatën e Parkut Kombëtar Prespë, organizuan në zonën e Parkut Kombëtar Prespë një ceremoni festive. Ky aktivitet u organizua në kuadër të programit SENiOR-A, i zbatuar nga REC-Albania dhe financuar nga Qeveria Suedeze.

Aktiviteti kishte si qëllim promovimin e vlerave natyrore të zonës të cilat ndërthuren me ato kulturore e njerëzore si dhe vendosjen e theksit mbi traditat e larmishme që mbart zona dhe komuniteti i Parkut Kombëtar Prespë, ruajtjen e qëndrueshme të këtyre vlerave kulturore dhe natyrore dhe

promovimin e tyre në vazhdim.

Kjo festë tashmë është shndërruar në një ritual tradicional në zonë dhe zhvillohet në fund të vitit, kur vera merret nga fuçitë dhe përgatitet për përdorim gjatë dimrit dhe vitit të ardhshëm. Kjo festë ka zgjuar interesin dhe pjesëmarrjen e komunitetit të zonës dhe rajoneve përreth për mundësitë marketuese që ofron në këtë periudhë të vitit.

Një vend të veçantë në aktivitetet e organizuara e zuri konkursi për verën më të mirë nga prodhuesit e zonës. Prodhimet konkurruese u hodhën në shishe me etiketa dhe numra, ku secili numër i përkiste një emri të prodhuesit që merrte pjesë në konkurs. Paraprakisht u ngrit një juri prej 5 vetash me antarë nga shoqëria civile, pushteti vendor, përfaqësues të komunitetit dhe administratës së parkut. Fituesve të konkursit iu shpërndanë çmime simbolike.

Pjesë e aktivitetëve ishte edhe takimi i katërt i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës. Në të morën pjesë përfaqësuesit e gjashtë organizatave përbërëse të rrjetit: INCA-Tiranë, Green&Clean-Korçë; Mbrojtja e Mjedisit-Kukës; Miqësia-Ulëz; Adriatiku-Vlorë; Iliria-Tiranë; Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës-Shkodër. Në takim u diskutuan ecuria e deritanishme e veprimtarisë së rrjetit, raportimi i punës nga secila organizatë anëtare, si dhe hartimi i programeve për vitin 2014.

Vazhdon procesi për shpalljen e Parqeve Natyrore Rajonale

Në datë 23 Dhjetor 2013, INCA në bashkëpunim me shoqatën Iliria dhe pushtetin vendor të Komunës Kthellë, në kuadër të programit të projektit SENiOR-A, i zbatuar nga REC-Albania dhe financuar nga Qeveria Suedeze, organizuan seminarin me temë “Fuqizimi i autoriteteve lokale dhe rolit të OJF-ve për shpalljen e Parqeve Natyrore Rajonale”.

Në takim morën pjesë përfaqësues të administratës së komunës, kryetari i komunës Kthellë, përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, të organizatave të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës, përfaqësues të shoqatës së Përdoruesve të pyjeve komunale etj.

Për të pranishmit e interesuar për këtë proces, u prezantua studimi i biodiversitetit të zonës, vlerat social-ekonomike të saj, procesi i hartografimit tematik për të përcaktuar



zonat me shkallë të ndryshme të biodiversitetit, metodikën e përdorur në këtë rast, si dhe hapat e përgatitjes së paketës paraprake të dokumenteve për *Vijon në faqen 5*

Vijon nga faqe 4 propozimin e shpalljes së Parkut Natyror Rajonal të Kthellës. Për vitin 2014 ky projekt do të vazhdojë me hartimin e Planit të Menaxhimit, zonimin përfundimtar si dhe propozimin për miratim në Këshillin

e Qarkut Lezhë. Përfaqësuesit e Komunës së Kthellës garantuan mbështetjen Komunës si dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Aksion ndërgjegjësues në mbrojtje të pasurive natyrore dhe turistike të Sarandës

Rrjeti “ECIM”, në kuadër të fushatave ndërgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, zhvilloi në Ksamil në datën 3.12.2013, një takim me tematikën “Aksion ndërgjegjësues në mbrojtje të pasurive natyrore dhe turistike të Sarandës”. Takimi u organizua nga Qendra “Grupimi

të dëmtuar të Ksamilit. Prej disa vitesh është lejuar që në një zonë të mbrojtur të parkut të kryhet një krim mjedisor nëpërmjet gërmimeve dhe tjetërsimeve vrastare të mjedisit dhe peizazhit, u shpreh në takim drejtuesi i “AJMMI”, z. Shkelqim Hajno.



Një tjetër fokus i takimit ishte parandalimi i një rreziku të mundshëm që i kanoset ligatinës së fushës së Vrinës nga tharja, e cila bën pjesë në Konventën Ndërkombëtare Ramsar. Për këtë do të përgatitet një Letër Vëmendje, drejtuar disa ministrive. Gjithashtu do të hartohet një marrëveshje bashkëpunimi me komunën e Ksamilit, zyrën e Parkut të Butrintit dhe më gjerë.

Ekolevizja” në bashkëpunim me partnerin lokal në Sarandë “Agjencia Joniane e Mjedisit Medias dhe Informacionit (AJMMI)” dhe u mundësua me mbështetjen e Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC), në kuadër të Programit SENiOR-A. Pjesëmarrja e gjerë në takim vlen për t’u përshëndetur, pasi tregon sensibilitetin e komunës Ksamil, shoqatave lokale mjedisore, komunitetit, gjimnazistëve etj. rreth problematikës së shkatërrimit të ishujve të Ksamilit nga bizneset. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe z. Besnik Abedini krytari i komunës Ksamil dhe Ilir Hysi nga nënprefektura, të cilët shprehën gadishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me rrjetin “ECIM” në lidhje me mundësinë e rehabilitimit të ishullit më të dëmtuar. Pas takimit u zhvillua një vizitë studimore, përgjatë shëtitorës së Ksamilit për të vëzhguar dëmtimet që i janë bërë ishullit të Ksamilit.

Tryeza pati 2 drejtime kryesore: 1.Sensibilizimin e aktorëve dhe opinionit publik për parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme në brigjet e Ksamilit dhe ishujve të tij si dhe 2. Përgatitje për një ndërhyrje rehabilituese me angazhimin e kapaciteteve të rrjetit si dhe me praninë e 3 ekspertëve si ing. Qani Sejдини, Kristo Kauri, Ali Coka për të kthyer në atraksion mjedisor e turistik ishullin më



Z. Xhemal Mato drejtues i Qendrës “Grupmi Ekolevizja” dhe njëkohësisht i rrjetit “ECIM” u shpreh në takim: “Ne synojmë të bashkëpunojmë me pushtetin lokal, jo vetëm duke e nxitur por edhe duke zbatuar aktivitete konkrete për rehabilitimin e ishullit”

Ishujt e Ksamilit janë pjesë integrale e Parkut Kombëtar të Butrintit. Ata gëzojnë në letër një status të veçantë, duke bërë pjesë në zonën A të Parkut, kurse de fakto ato kanë rënë pre e ndërtimeve të cilat nuk duheshin lejuar.

“Nëse Ksamilit do ti hiqeshin ishujt, ai do të humbiste një burim natyror për zhvillimin e rajonit nga turizmi. Njëkohësisht do të humbisnim nga kënaqësia estetike, peizazhi që këto ishuj ofrojnë” – shtoi më tej në takim z.Mato.

EKOLEVIZJA

Përditësime nga çështja “Antea”

Në vijim të shkrimit “Antea shpërfill shtetin Shqiptar” (<http://www.eden-al.org/index.php?id=436>) fabrika e çimentos TITAN Antea Sh.A. ka reaguuar duke ndarë me qendrën EDEN informacione/dokumente mbi interesimin e tyre ndaj publikimit të raportit të Institutit të Shëndetit Publik “Mbi kontrollin e ushtruar në ajrin e mjedisit të banimit të fshatit Burizanë”. Për më shumë lexoni komunikimin e fabrikës dhe dokumentet bashkëngjitur me të dhëna shtesë për çështjen ([www.eden-al.org/media/Letra%20drejtuar%20EDEN%](http://www.eden-al.org/media/Letra%20drejtuar%20EDEN%20dhe%20monitorimi%20i%20ajrit%20nga%20Antea.pdf)

[20dhe%20monitorimi%20i%20ajrit%20nga%20Antea.pdf](http://www.eden-al.org/media/Letra%20drejtuar%20EDEN%20dhe%20monitorimi%20i%20ajrit%20nga%20Antea.pdf))

Rrjeti vigjilues “Një sy për mjedisin” e falenderon fabrikën për komunikimin mbi çështjen dhe i rekomandon asaj të përmirësojë komunikimin me komunitetin lokal duke ofruar dhe praninë e tij në çdo përpjekje të fabrikës për këtë qëllim. Për më shumë lexoni letrën tonë: (www.eden-al.org/media/Leter%20pergjigje%20Anteas.pdf)

Qendra EDEN

NJOFTIME

- 1- WWF opens a content for Prince Bernard Scholarships for Nature Conservation. You can find more about the content on http://wwf.panda.org/how_you_can_help/volunteer/prince_bernard_scholarships/. Please send your application till 11/01/2014 on ikorn@wwf.panda.org and write Prince Bernard Scholar ships 2014.
- 2- The European Topic Centre on Biological Diversity (ETC/BD) is seeking a 'Nature Directives Officer', for its office in Paris. The post starts in January 2014. For further details, please see the announcement in English and in French. <http://bd.eionet.europa.eu>
- 3- Programe Master për Zonat e Mbrojtura. Universiteti Klagenfurt në Austri, organizon raundin e pestë për programet Master për Zonat e Mbrojtura. Për më tepër informacion: http://mpa.e-c-o.at/newsreader/items/mpa_news_48.html
- 4- PA management and transboundary conservation expert. www.iucn.org/europe ; www.iucn.org/southeasterneurope
- 5- Recruitment for Director General of IUCN. A detailed job description and instructions to apply for this position are available at: www.iucn.org/dg-search

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në buletin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes buletinit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

- Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro